



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

SCC-10-0331

Paditësit

1. **H M**, Prizren.
2. **G G** Prizren.
3. **A L** Suharekë.
4. **H B** Suharekë.
5. **Q G** Suahrekë.
6. **M E** Suharekë.
7. **Y E** Suharekë.
8. **N B**, Suahrekë.
9. **D E**, Suharekë.
10. **A G** Suahrekë.

Kundër

E paditura

NSH K B “K” Suharekëë, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 18 nëntor 2020, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar, padia e paditësve **H M, G G, A L, H B, Q G, M E, Y E, N B, D E** dhe **A G**.
- II. **Nuk caktohen** taksa gjyqësore për paditësit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 20 shtator 2007, paditësit dorëzuan në Gjykatën Komunale në Suharekë, padi kundër NSH K “K” Suharekë dhe AKP, për pagimin e të ardhurave personale të pa realizuara, për periudhën prej 01 korrik 2002.

Gjykata Komunale në Suharekë, me aktvendimin C.nr. 198/2007 të datës 31 korrik 2008, ka vendosur se i mungon juridiksioni primar për vendosjen e kësaj çështje juridike, përderisa ky juridiksion nuk i referohet nga Dhoma e Posaçme.

Gjykata e Qarkut në Prizren duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, me aktvendimin Ac.nr. 389/2008 të datës 22 dhjetor 2009 e ka aprovuar ankesën e paditësve si të bazuar dhe e ka prishur aktvendimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr. 198/2007 të datës 31 korrik 2008 dhe lëndën e ka kthyer në procedurë tëserishme.

Me 22 tetor 2010 Gjykata Komunale në Suharekë ka mbajtur seancën e shqyrtimit përgatitor.

Gjykata Komunale në Suharekë me aktvendimin C.nr. 272/2009 të datës 22 tetor 2010 është shpallur jo kompetente për zgjidhjen e kësaj çështjekonforme neneve 392 al 1 pika (b), 19, 23 dhe nenit 66 të LPK dhe ka vendosur që pasi aktvendimi të bëhet i formës së prerëlënda të dërgohet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Me 26 gusht 2014 paditësit me parashtrësë e kanë plotësuar padinë me kërkesa të reja, me të cilën kanë kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, për pagat e pa paguara në kohë të pa caktuar dhe 3 paga të pa paguara pas shpalljes së procesit të likuidimit tëaseteve të Kooperativës nga AKP në Prishtinë. Si provë kanë bashkangjitur kopjet e Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.

Me 28 shtator 2020, e paditura AKP parashtroi përgjigje në padi, në të cilën pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësve të paraqitura në padinë e tyre, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe si e tillë duhet të refuzohet. Me tej e paditura pohoi se paditësit nuk kanë prezantuar fakte në kuptim të nenit 7 të ligjit mbi procedurën kontestimore ku theksohet se “Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Arsyetimi ligjor:

Padia refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuarvërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqiturapo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala etillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*eiincumbitprobatioquidicit*).

Në këtë rast paditësit nuk kanë ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxhpagat e kërkuara, po ashtu paditësit nuk kanë ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Paditësit kanë dështuar që të dorëzojnë prova relevante edhe pas plotësimit të padisë. Gjkata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësve lidhur me të drejtën e saj në kompensim përpagate pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Paditësit e kanë paguar taksën gjyqësore për padinë e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare
Hajrie Shala